



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 106, datë 18.10.2010

PËR

**LICENCIMIN E “SHOQËRISË ADMINISTRUESE TË FONDEVE TË PENSIONIT
RAIFFEISEN– RAIFFEISEN PENSION FUNDS MANAGEMENT COMPANY”**

Në bazë dhe për zbatim të pikës 6, nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe nenit 26 dhe 27 të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, me propozim të Departamentit të Licencimit e Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Në bazë dhe për zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, neni 108, institutet ekzistuese të pensioneve, të krijuara në përputhje me Ligjin nr. 7943, datë 01.06.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, duhet të paraqesin kërkesën për licencë brenda një viti nga hyrja në fuqi e ligjit.

Në zbatim të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009, shoqëria “Instituti Privat i Pensioneve Suplementare Raiffeisen-Raiffeisen Pensions” sh.a, depozitoi në AMF kërkesën dhe dokumentacionin për licencim. Përmbushja e kërkesave ligjore lidhur me dokumentacionin e paraqitur është si më poshtë:

- Shoqëria është themeluar si shoqëri aksionare, e cila zotërohet 100% nga shoqëria “Raiffeisen Bank” sh.a.
- Shoqëria është e organizuar sipas sistemit me një nivel. Këshilli i Administrimit përbëhet nga 7 anëtarë me mandat 3 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje. Këshilli ka emëruar 2 persona si administratorë dhe përfaqësues të shoqërisë. Administratorët janë njëkohësisht edhe anëtarë të Këshillit të Administrimit.
- Shoqëria plotëson kërkesat për kapital.
- Emri i propozuar i shoqërisë është “Shoqëria administruese e fondeve të pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company” sh.a.
- Objekti i veprimtarisë përputhet me aktivitetin që do të kryejë shoqëria.
- Plani i biznesit përmban të gjitha të dhënat e kërkuara nga ligji.
- Shoqëria ka paraqitur informacion të detajuar mbi sistemet e teknologjisë së informacionit.
- Shoqëria ka nënshkruar kontratën me depozitarin e licencuar.
- Nga dokumentacioni dhe CV-të, rezulton se Anëtarët e Këshillit Administrativ

kanë kualifikime, aftësi profesionale dhe eksperiencë pune duke veçuar: licencë për administrimin e fondeve të pensionit, trajnime në administrimin e fondeve të pensionit, Diplomë të Certifikuar për Menaxhimin e Fondeve dhe të Portofoleve, studime pasuniversitare, etj. Administratori kryesor i “Shoqërisë administruese të fondeve të pensionit Raiffeisen-Raiffeisen Pension Funds Management Company” sh.a, ka eksperiencë mbi 5 vjet si drejtor e menaxhimit të riskut në institucione financiare, si dhe eksperiencë pune, aftësi profesionale dhe administruese, certifikata për trajnime afatshkurtër në administrimin e fondeve, etj.

Pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit të paraqitur, rezultoi se aplikanti për licencë plotëson kërkesat ligjore për t’u licencuar si shoqëri administruese e fondit të pensionit. Anëtarët e Këshillit Administrativ dhe administratorët janë të përshtatshëm dhe të aftë për të mbajtur pozicionet e caktuara por krahas njohurive profesionale të përmendura më sipër dy administratorët kryesorë të shoqërisë duhet të plotësojnë aftësitë e tyre profesionale me kualifikime shtesë për administrimin e fondeve të pensionit vullnetar. Derisa të plotësohet kjo kërkesë, disa kompetenca të administratorëve duhet t’i kalojnë Këshillit të Administrimit.

Për sa më sipër, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e “Shoqërisë administruese të fondeve të pensionit Raiffeisen-Raiffeisen Pension Funds Management Company” sh.a, për të vepruar si shoqëri e administrimit të fondeve të pensionit vullnetar, për mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensioneve, si dhe kryerjen e pagesave të pensionit, me kusht që:
 - a) Administratorët e shoqërisë administruese të plotësojnë më tej aftësitë e tyre profesionale me kualifikime shtesë për administrimin e fondeve të pensionit vullnetar, brenda 3 vjetësh.
 - b) Këshilli i administrimit gjatë periudhës së përcaktuar në pikën a) të ushtrojë disa nga kompetencat e administratorëve lidhur me administrimin e aseteve të fondeve.
 - c) Shoqëria të paraqesë menjëherë pranë AMF-së një plan të detajuar për plotësimin kushteve të mësipërme.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI